

Reagim botuar me ndryshime te vogla, me dt 23.10.2012 ne gazetate "Sot",  
"Telegraf" dhe "Zëri Popullit"

## APEL POLITIKANËVE

E përgëzojmë zotin Kreshnik Spahiu, për distancimin e tij duke deklaruar publikisht se ligji 7501 është tradhëti kombëtare dhe luftë civile Ky deklarim i tij në TV. News 24 dt. datë 21.10.2012, është në vijim të deputetit Pandeli Majko që e deklaroi anarkinë e pronës si krim kolektiv të politikës së pas vitit 1991.

Në fakt Ligji 7501 është dekretuar nga Ramiz Alia dhe është përkeqësuar me vonë nga Sali Berisha. Në vitin 1991 Sali Berisha në qytetin Studenti ka deklaruar se Ramiz Alia është perla e politikës . Në emër të pronarëve të ligjshëm të shpronësuar nga diktatura , sot **presim prononcimin e zotit Sali Berisha, Ilir Meta, Edi Rama dhe Bamir Topi për ligjin 7501. Eshtë koha për të vepruar duke përfunduar në radhë të parë kthimin fizik të pronës tek I zoti. Këtë e kërkon ne faqen 21, dhe Progress Raporti I KE I datës 10.10.2012.**

Ky ligj që është fillimi i menaxhimit të keq të demokracisë, është themeli i anarkisë me pronat, është shkaku që të drejtat e pronësisë vazhdojnë të mohohen, është shkaku i zbatimit të standardeve të dyfishta, është shkaku që ka futur në luftë shqiptarët kundër shqiptarëve, është ligji që i shërben helenizimit të Shqipërisë së jugut dhe nuk realizon demokraci por riciklon një klan të caktuar në ekonomi dhe në politikë. Ky ligj e ka transformuar sistemin e diktaturës komuniste në sistem **kleptokratik ku predominon korrupsioni** . Ligji 7501, për pjesën ku pronarët nuk kanë marrë pronën e tyre të trashëguar, është burimi i korrupsionit të politikanëve dhe i shumë të këqijave që kanë pllakosur mbi popullin Shqiptar pas vitit 1991. **Per shkak të këtij ligji shumë shqiptarë po shkojnë në 100 vjetorin e pavarësisë të xhveshur nga prona e trashëguar sepse pronat e tyre në emër të ligjit, i kanë përvetësuar ose vjedhur pushtetarët.**

Ligji 7501 dhe specifikiisht neni 8 i tij, e konsideron pronën e grabitur nga sistemi komunist si pronë në dispozicion të qeveritarëve dhe politikanëve. Këtë ligj e kemi analizuar me dhjetra e dhjetra herë duke argumentuar dhe denoncuar si ligj antidemokratik, antikombëtar dhe veprimtari të agjentuarave dhe te influencave agjenturore në politikën e periudhës postkomuniste. Luftën tonë ndaj këtij ligji që po shkatërron themelet e Shqipërisë, e vërtetoi "Shoqata e Pajtimit Mbarëkombëtar" e cila pas hetimit të

aktivistëve të saj në terren ka denoncuar se nga ky ligj , prej vitit 1991 deri në 2011 ka shkaktuar mbi 6000 viktima. Këtë denoncim politika e ka përcjellë me heshtje.

**Rrapo Hajredin Danushi**

**Kryetar i Shoqatës Kombëtare të të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi”**